Republika e Kosovës

Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 343/19
Data/Datum. 06.08.2019
PRISHTINË - PRIŠTINA

PSH.nr. 343/19

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje z. Goran Milenković – Kryetar, z. Nuhi Paçarizi - Referues, z. Blerim Dina – Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik "Sodex Group"SH.P.K.– Prishtinë, kundër vendimit të AK-së- Njoftimi për dhënie të kontratës, ku i rekomanduar për dhënie te kontratës është OE "Union LLC", lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull prokurimit: "Furnizimi me Instrumente metalprerës, LOT 2", me numër të prokurimit: 19-111-1-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Korporata Energjetike e Kosovës SH.A. (KEK), më datën 25.07.2019, mori këtë:

V E N D I M

I. <u>APROVOHET</u>, pjesërisht si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik "Sodex Group"SH.P.K.– Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizimi me Instrumente metalprerës, LOT 2", me numër të prokurimit: 19-111-1-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – "KEK" SH.A.

II. <u>ANULOHET</u> vendimi i AK-së - Njoftimi për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizimi me Instrumente metalprerës, LOT 2", me numër të prokurimit: 19-111-1-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – "KEK" SH.A. dhe aktiviteti i prokurimit në fjalë kthehet në **Rivlerësim.**

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 23.9 dhe 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues "Sodex Group"SH.P.K.– Prishtinë, aprovohet pjesërisht si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Data e njoftimit për kontratë: 18.01.2019
Lloji i procedurës së aplikuar:.Procedurë e hapur
Lloji dhe vlera e kontratës së publikuar: Kontratë publike furnizim, Blerje
Vlera e parashikuar e kontratës LOT 2:. 25.000,00 €
Kriteri për dhënie të kontratës(N.52) Tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët
Afati i fundit për dorëzimin e ofertave:13.02.2019
Data e hapjes së ofertave: 13.02.2019
Njoftimi mbi vendimin e AK 11.06.2019
Data e vendimit të AK-së lidhur me kërkesën për rishqyrtim: 20.06.2019
Data e vendimit lidhur me kërkesën për rishqyrtim pranë OSHP-se .26.06.2019

Operatori ekonomik ankues "Sodex Group"SH.P.K.– Prishtinë, si palë e pa kënaqur, ka deponuar ankesë në OSHP, me 26.06.2019 me nr. 343/19, kundër vendimit të AK-së- Njoftimi për dhënie të kontratës, ku i rekomanduar për dhënie te kontratës është OE "Union LLC lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizimi me Instrumente metalprerës, LOT 2", me numër të prokurimit: 19-111-1-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – "KEK"SH.A., duke pretenduar ne shkelje te këtyre dispozitave ligjore:

- Neni 1 LPP-së
- Neni 6 LPP-së
- Neni 7 LPP-së
- Neni 56.3 LPP-së

- Neni 59 LPP-së
- Neni 60 LPP-së
- Neni 72 LPP-së

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 03.07.2019 ka autorizuar ekspertin shqyrtues profesional të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti Shqyrtues në raportin e dt: 04.07.2019, konstaton dhe sqaron si në vijim

Përgjigje në Pretendimet ankimore : Sodex Group" shpk- Prishtinë

Eksperti shqyrtues / teknik sqarona se AK me rastin e riemërimin e ofertave e ka cilësuar gabim aritmetik mos vendosjen e TVSH , pra AK e ka cilësuar përqindjen e TVSH si gabim aritimetike dhe qe njëherë sipas AK –se bijën ne kundërshtim me dispozitat e neni 59 LPP-se .

Eksperti shqyrtues vlerëson se nuk qëndron arsyetimi i AK –KEK se kemi te bëjmë me gabim aritmetik sepse një situata e tille është e sqaruar në pyetje/përgjigje nr.46 të publikuar ne Webfaqen e KRPP-së , në të cilën thuhet :

46. Si të veprohet në rastet kur një Operator Ekonomik normën e TVSH-ës të përcaktuar me ligjin mbi TVSH-ën, për një apo më shumë artikuj në ofertën e tij e vendos gabimisht pra e vendos jo në bazë të normës së përcaktuar me Ligjin mbi TVSH-ën?

Në rast se një Operator Ekonomik ofron një çmim ku % (përqindja) e TVSH-ës është e gabuar (më e lartë apo më e ultë se norma e aplikueshme e TVSH-ës) Autoriteti Kontraktues do ta korrigjoj % (përqindjen) e atij apo atyre artikujve në bazë të normës së aplikueshme të TVSH-ës pa pasur nevojë të kërkoj sqarime shtesë nga Operatori Ekonomik në fjalë.

Eksperti shqyrtuese ne fund pas shqyrtimit te te vetmit pretendim te parashtruar ne aknes nga OE ankues konstatona se AK –ja në kundërshtim me nenin 59 LPP-se ka bere verimin e ofertave dhe njehe rit nuk është respektuar neni 60 LLP-se – Tenderi I përgjegjshëm me çmim me te ulet sepse Autoriteti kontraktuese ka vepruar ne kundërshtime me pyetje/përgjigje e larte cekur.

Prandaj Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues-teknik duke u bazuar në sqarimet e dhëne si më larte dhe ne pyetjen nr.46 te publikuar në wb faqe e KRPP-se vlerësona se pretendimi ankimore është i qëndrueshëm për shkeljet e dispozitat e LPP-se te cekura ne ankese.

Autoriteti Kontraktues përmes parashtresës me shkrim nuk e ka njoftuar Panelin shqyrtues se nuk pajtohet apo jo me raportin e ekspertit shqyrtues.

Operatori ekonomik ankues përmes parashtresës me shkrim të datës: 05.07.2019, ka njoftuar Panelin shqyrtues se pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues

Në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 25.07.2019, ku kanë qenë prezent paneli shqyrtues, përfaqësuesi i autoritetit kontraktues dhe operatorit ekonomik ankues, u shqyrtuan shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues, parashtresat e palëve në procedurë.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i OE-së z. Fetoshi deklaroj: Pasi qe kjo ankese është e përsëritur në do të flasim shkurt për pretendimet ankimore konsiderojmë se në ketë AP jemi eliminuar për një kërkese e cila nuk ka qenë pjesë e FDT-së kështu qe Autoriteti Kontraktues ne ketë rast ka vepruar ne kundërshtim me nenin 56 paragrafi 3 i LPP-së. Si kërkese e FDT-së ne nenin 5.4 ka qenë e parashikuar qe për mallrat e importuara ne ketë AP OE duhen te lirohen nga pagesa e TVSH-së dhe ne kemi ofertuar pa TVSH në ketë AP, duke ofruar çmimin me te ulet dhe duke e plotësuar kriterin kryesor për dhënie te kontratës tenderi i përgjegjshëm me çmim me te ulet. Mirëpo edhe nëse duhet te ofertohet me TVSH eventualisht ne ketë rast duhet të merret parasysh edhe interpretimi i KRPP-së tek pyetjet e shpeshta me nr 46. ku sqarohet se nëse TVSH është dhënë gabimisht atëherë ajo duhet korrigjuar sepse dihet se sa është vlera e TVSh -së në Kosovë. Duke u bazuar edhe ne pretendimet tona që kemi dhënë ne ankese.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi të AK-së z. Fazliu i deklaroj: Autoriteti Kontraktues nuk pajtohet me mendimin e ekspertit sepse në e kemi rivlerësuar ketë AP në bazë te vendimit te OSHP-së me nr 167/19 vendim te cilin eksperti nuk e ka përmend ne ekspertizën e vet pasi qe pretendon se e OE janë te njëjta dhe janë shqyrtuar paraprakisht nga paneli duke u bazuar ne ketë dhe faktet ne panelin e pare kërkojmë qe paneli te punoj ne rregulloren e brendshme 01-2017 pika 16.2 pasi behet për te njëjtat pretendime ankimore te nijetin ankues dhe pasi qe një here ka qenë e vendosur me vendimin 167/19.

Vendimin e OSHP-së e kemi zbatuar në përpikëri ku thuhet në rastin e rivlerësimit çmimeve te ofruar nga OE te ju shtoni sipas normave te aplikueshme dhe nëse pas kalkulimi çmimi i ofruar nga OE Ankues kalon 2% te vlerës totale te ofertës atëherë AK duhet te veproj ne ligjin 59.3 dhe ne kemi vepruar sipas këtij neni.
Deri sa OE e thotë se nuk është e kërkuar ne FDT ne e themi me përgjegjësi te plote se pika 5.2 është e kërkuar tek kushtet e dërgesës :Inkotermi DDP me TVSH.

Gjatë prezantimit në seancë Ekspertja Shqyrtues z. Saramati deklaroj: Qëndrojmë prapa raportit te dhënë në ekspertize

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i OE-së deklaroj: Kërkojmë nga paneli shqyrtues te aprovohet ankesa jone si e bazuar dhe lënda te kthehet ne rivlerësim.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i AK-së deklaroj: kërkojmë qe ankesa te refuzohet si e pabazuar dhe te vazhdohet me dhënie te kontratës për Lot 2.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të operatorit ekonomik ankues, konstatimeve analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues dhe shoshitjes së provave në tërësi në shqyrtim kryeso konstaton se AK me rastin e rivlerësimit të ofertave e ka cilësuar gabim aritmetik mos vendosjen e TVSH , pra AK e ka cilësuar përqindjen e TVS-së si gabim aritmetikë dhe qe njëherë sipas AK –se bijën ne kundërshtim me dispozitat e neni 59 LPP-së.

Paneli shqyrtues konform Eksperti shqyrtues-teknik vlerëson se nuk qëndron arsyetimi i AK –KEK, se kemi të bëjmë me gabim aritmetik sepse një situata e tille është e sqaruar në pyetje/përgjigje nr.46 te publikuar ne Webfaqen e KRPP-së , në te cilën thuhet :
46. Si të veprohet në rastet kur një Operator Ekonomik normën e TVSH-ës të përcaktuar me ligjin mbi TVSH-ën, për një apo më shumë artikuj në ofertën e tij e vendos gabimisht pra e vendos jo në bazë të normës së përcaktuar me Ligjin mbi TVSH-ën?

Në rast se një Operator Ekonomik ofron një çmim ku % (përqindja) e TVSH-ës është e gabuar (më e lartë apo më e ultë se norma e aplikueshme e TVSH-ës) Autoriteti Kontraktues do ta korrigjoj % (përqindjen) e atij apo atyre artikujve në bazë të normës së aplikueshme të TVSH-ës pa pasur nevojë të kërkoj sqarime shtesë nga Operatori Ekonomik në fjalë.

Paneli shqyrtues konform Eksperti shqyrtues-teknik ne fund pas shqyrtimit te të vetmit pretendim te parashtruar ne aknes nga OE ankues konstatona se AK –ja ne kundërshtim me nenin 59 LPP-se ka bere vlerësimin e ofertave dhe njeherit nuk është respektuar neni 60 LLP-së – Tenderi i përgjegjshëm me çmim me te ulet sepse Autoriteti kontraktuese ka vepruar në kundërshtime me pyetje/përgjigje e larte cekur.

Prandaj paneli shqyrtues konfotrm ekspertit shqyrtuese-teknik konstaton se duke u bazuar në sqarimet e dhëna si më lartë dhe në pyetjen nr.46 të publikuar në wb faqë e KRPP-së konstatojmë se pretendimi ankimor është i qëndrueshëm për shkeljet e dispozitat te LPP-së të cekura në ankesë.

Paneli shqyrtues vjen në përfundim se ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë konform nenit 59 të LPP-së . Prandaj obligohet autoriteti kontraktues që gjatë rivlerësimit të ofertave dhe në të ardhmen ti përmbahet në detaje të gjitha dispozitave të LPP-së dhe kërkesave të dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesë padi mund t'i drejtohet vetëm Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative për kompensim dëmi ne afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit .

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

Z. Goran Milenković

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK – Korporata Energjetike e Kosovës SH.A.

1x1 OE- "Sodex Group"SH.P.K.– Prishtinë

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në web- faqe të OSHP-së.